

## Shqiptarët dhe rajonet perëndimore të Amerikës

*Gjatë mbajtjes së Seminarit për Gjuhën dhe Kulturën Shqiptare për albanologët e huaj, bëmë një bisedë me njërin nga pjesëmarrësit, me dr. Robert Elsin, i cili tashmë është i njohur si njëri nga përkthyesit më të vyeshëm nga letërsia shqipe në gjuhën gjermanishte dhe në gjuhën anglishte. Shkas për bisedë, prandaj, nuk ishte pjesëmarrja e tij në Seminar, por puna e deritashme përkthyesë e kurorëzuar me Antologjinë e poezisë shqipe, përkthimin e veprës poetike të Migjenit dhe me Leksikonin e shkrimtarëve shqiptarë. Të bindur se biseda me intelektualë dhe krijues të tillë që krijon ura njohjeje e miqësie midis popujve e kulturave të ndryshme nuk humb nga aktualiteti, po e sjellim në këtë numër të revistës sonë.*

[MK]: Lexuesit tanë kanë dëgjuar për ju dhe për punën tuaj në fushë të përkthimit nga shqipja. Megjithatë, do t'ju lusnim që për ta të na i jipni disa njoftime biografike.

[RE]: Jam i lindur në Vankuver të Kanadasë në vitin 1950. Atje kam studiuar katër vjet në Universitetin British Columbia, në fushën e gjuhësisë. Pastaj kam ardhur në Evropë dhe kam studiuar në Universitetin e Lirë të Berlinit. Prej aty kam kaluar në Francë, përkatësisht në Paris, ku kam studiuar në Shkollën Praktike të Studimeve të Larta. Më vonë kam shkuar në Dublin (Irlandë), ku kam ndjekur studime në Institutin e Studimeve të Larta. Në vitin 1978 kam doktoruar në shkencat filologjike në Universitetin e Bonit. Edhe tash jetoj në Bon, ku më parë kam punuar si profesor i gjuhës angleze, ndërsa tash jam përkthyes i lirë. I paraqita në mënyrë panoramike apo telegrafike disa pika të rrugës sime jetësore përkatesisht të interesimeve të mia që besoj se dëftojnë prirjet dhe ambiciet e mia.

[MK]: Në këtë shumësi studimesh dhe interesimesh nëpër universitetet e ndryshme, na intereson të dimë siç ju shtyri të mirreni edhe me kulturën shqiptare?

[RE]: me kulturën dhe me letërsinë shqiptare kam zënë të mirrem nga vitet 1978 kur isha për të parën herë në Seminarin për Gjuhën dhe Kulturën Shqiptare në Prishtinë. Po atë kohë shkova edhe në Tiranë me një grup studentësh nga Universiteti i Bonit. Motivi vendimtar për t'u marrë me këtë kulturë qëndron në të dhënë se ajo është një kulturë e lashtë evropiane në njërin anë dhe se është tepër pak e njohur pikërisht në Evropë, në anën tjetër. Ky është një paradoks i çuditshëm. Kultura shqiptare në Evropë deri vonë pa të drejtë është trajtuar si një kulturë orientale e që është pasojë e drejtpërdrejtë e mosnjohjes së qenësisë së saj. Kjo mosnjohje e kulturës shqiptare në Evropë ka bërë që ajo të njihet e të ndikojë më pak në mozaikun e kulturave se kultura e Tibetit, fjala vjen. I kam dhënë vetës për mision që të punoj aq sa të mundem e të di që kjo padrejtësi të ndreqet e që kultura juaj të trajtohet ashtu si e meriton, pra si kulturë evropiane. Në antologjinë e poezisë shqiptare që e kam botuar në gjermanishtë, kam cituar mendimin e historianit të njohur anglez Edward Gibbon, i cili thotë se Shqipëria nuk është as njëqind kilometra larg Italisë ndërsa ne e njohim më pak atë se rajonet perëndimore të Amerikës.

Këtë e ka thënë në shekullin e kaluar ndërsa tash ky absurd vetëm sa është thelluar edhe më.

[MK]: Në kuadër të interesimeve tuaja të shumta që dëshmohen me faktin se i flisni njëzet e tri gjuhë të ndryshme, ç'vend zë interesimi për shqipen?

[RE]: Interesimi për shqipen ka filluar si më vonë dhe në fillim kam përparuar ngadalë. Tash për tash, është në qendër të punës sime studimore dhe përkthyesë. Mund të them se tashmë e kam zotëruar shumë mirë gjuhën, e kam të plotë përfytyrimin për natyrën e saj e në anën tjetër për letërsinë shqiptare kam një bazë të mirë informacioni e cila më mundëson që me të të mirrem edhe më intensivisht në të ardhmen. Besoj se do të jetë pikërisht kështu.

[MK]: Keni përpiluar Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë që është një projekt vetvetiu serioz. Më ç'vështirësi jeni ballafaquar gjatë përpilimit të tij?

[RE]: Vështirësitë më të mëdha i kam pasur rreth sigurimit të materialit të nevojshëm për këtë projekt ngase në Gjermani ku kam punuar, nuk gjenden të gjitha botimet shqipe. E drejta, ka dy biblioteka mjaft të furnizuara: Biblioteka Shtetërore e Mynhenit në Bavari dhe Biblioteka Prusiake në Berlinin Perëndimor. Në këto dy biblioteka kam gjetur një numër të madh veprash që më duheshin. Megjithatë, një numër tjetër të tyre nuk e kam gjetur as në këto biblioteka, prandaj më është dashur të vijë këtu që është një vështirësi shtesë në tërë këtë punë. Me kënaqësi mund të them se e kam pasur ndihmën e disa kolegëve të Institutit Albanologjik të Prishtinës për çka u jam shumë mirënjohës.

[MK]: Ju jeni edhe autor i Antologjisë së poezisë shqipe. Na intereson të dimë se mbi ç'kriterë e keni përpiluar këtë antologji?

[RE]: Antologjinë e poezisë shqipe të cilën e konsideroj si një projekt timin të guximshëm dhe të cilit nuk i kam ngarkuar vetëm funksion informativ e kam përpiluar duke u mbështetur në tri kriterë kryesore: (1) kriteri historiko-letrar më është imponuar nga fakti se kjo është antologjia e parë e poezisë shqiptare në gjuhën gjermane dhe si e tillë ajo do të duhej të krijonte tek lexuesi një përfytyrim sa më të plotë për rrugën e zhvillimit të kësaj letërsia, proceset stilistike që janë shfaqur e janë transformuar në të, me një fjalë që t'i krijonte lexuesit idenë për kontinuitetin e zhvillimit dhe ekzistimit të saj. Për këtë arsye edhe kam përfshirë në këtë Antologji autorë që nga Pjetër Budi, H. Z. Kamberi, N. Frakulla, N. Keta, N. Frashëri, Çajupi, De Rada, Mjeda, Asdreni, L. Poradeci, Migjeni, D. Agolli, I. Kadare, E. Gjerqeku, F. Arapi, A. Podrimja, N. Lako, V. Ujko, A. Arnauti, M. Kërveshi etj. Këtu përmenda vetëm disa nga autorët e përfshirë në Antologji po edhe këta që përmenda e projektojnë kontinuitetin prandaj edhe e mbështesin kriterin historiko-letrar; (2) kriteri i dytë të cilit i jam përmbytur ka qenë thjesht estetik. Pra, kam synuar që Antologjia ime të lexohet nga një numër sa më i madh lexuesish dhe të përjetohet prej tyre si vlerë estetike. Besoj se edhe kjo është përmbytur në një masë të mirë; (3) gjatë përkthimit të disa autorëve kam pasur vështirësi të jashtëzakonshme sepse pothuaj ka qenë e pamundur të ruhet natyra e poezisë: ritmi, metri, frazeologjia, madje edhe mesazhi poetik gjatë përkthimit. Kjo më ka

shtrënguar që disa krijime vërtet me vlera të larta artistike të mos i përfshij në antologjinë time.

[MK]: Përpilimi i Antologjisë së cilëdo letërsie parakupton njohuritë solide të përpiluesit të saj. A mund të na thoni se cili është niveli i poezisë së sotme shqiptare, shikuar në një kuadër më të gjërë?

[RE]: Mund të them lirisht se niveli artistik i poezisë së sotme shqiptare është në rrjedhat e poezisë evropiane, jo në kuptim të përkatësisë gjeografike, por në kuptim të vlerës. Poezia juaj është çliruar nga patosi romantik dhe ka afirmuar gjurmimin drejt formave të larmishme të shprehjes e që shtrohet në faktin se janë afirmuar disa individualitete të forta. Po e theksoj sërisht se është dëm që kjo poezi nuk njihet sa duhet në Evropë, me çka do të fitonte vendin që i takon.

[MK]: Si pjesëmarrës i Seminarit, na thoni se sa ju ndihmon ai për t'i thelluar interesimet tuaja për gjuhën dhe kulturën tonë?

[RE]: Mund të them se Seminari më ndihmon mjaft ngase këtu i takoj albanologët nga të gjitha pjesët e botës. Për dy javë shoqërimi kemi rast të mirë të këmbëjmë përvojat tona dhe t'i thellojmë dituritë. Më janë shumë të dobishme takimet me shkrimtarët dhe albanologët e këtushëm të cilët më ndihmojnë me informacione të nevojshme lidhur me literaturë. Sa i përket vetë Seminarit përkatësisht mësimi që bëhet në të, mund të them se ai është kryekëput për fillëstarët ndërsa për ne që kemi një fond më solid të dijes në këtë fushë, ai nuk na ndihmon shumë. Po edhe me ato që përmenda më lart, Seminari na i përmbush kërkesat dhe është punë e mirë që ai mbahet.

[MK]: Në fund t'u bëjmë një pyetje që është e pashmangshme në biseda të këtilla: ç'plane keni për të ardhmen?

[RE]: Plane kam shumë dhe do të dëshiroja që t'i përmbush! Planifikoj të botoj një antologji të përrallës shqiptare në anglishte. Antologjinë e poezisë shqiptare që e kam botuar gjermanisht, do ta botoj edhe në anglishte. Kam ndërmend t'i hyj përpilimit të antologjisë së poezisë së sotme shqipe dhe ndoshta, edhe të një historie të letërsisë shqipe. Nga gjuhësia planifikoj një studim hidronomie ku do të merrem me historinë e emrave të lumenjve në Shqipëri. Sikundër shihet, plane kam mjaft po edhe shpresë se do t'i realizoj.

[MK]: A do t'i shtoni gjësend kësaj bisede?

[RE]: Meqë kjo bisedë i dedikohet revistës Fjala, të them se unë mendoj se kjo është revista më e mirëfilltë dhe më e plotë për çështje të kulturës, artit e letërsisë që del në gjuhën shqipe. Në të gjej informacione shumë të çmueshme për veprat e botuara dhe për rrjedhat kulturore në Kosovë.

Biseda e zhvilloi Milazim Krasniqi.

[botuar në / published in: gazeta *Fjala*, Prishtina, 1 nëntor/November 1988]